



## **KUVENDI I KOMUNËS** **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

### **EKSTRAKT**

**nga Procesverbali i mbajtur më 04 shtator 2018, në mbledhjen e V-të (pestë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës - DA, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - DSHPMSh, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ, Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Agim Blakqori, UD i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit - DKA, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI

### **Rendi i ditës**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth rendit të ditës, shtoi, nëse ndokush prej anëtarëve dëshiron të marr fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim sipas materialit të dërguar.

*Njëzëri nga anëtarët prezent (7 anëtar sa ishin për momentin) u miratua rendi i propozuar i ditës.*

### **1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, më 28 qershor 2018 dhe 30 korrik 2018**

*Njëzëri, pa vërejtje, u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve (po ashtu nga 7 anëtar sa ishin për momentin).*

## 2. Propozimi i vendimit për rialokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2018

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, rreth rialokimit nuk kam çfarë të zgjati shumë fillimisht ngase besoj se të gjithë jeni në dijeni për rëndësinë e rialokimit të buxhetit në këtë fazë të realizimit të buxhetit që jemi, ku njëra prej arsyeve është që buxheti të shpenzohet dhe mos të kemi suficid por të përmbushim obligimet tona sa i përket realizimit të projekteve. Për detaje tjera rreth kësaj pike, ka kërkuar fjalën hyrëse drejtori **z.Faik Muçiqi** i cili do të na jap arsyeshmërinë e këtij propozim vendimi.

Ndërkohë vlen të ceket se tani erdhën edhe dy anëtarë tjerë të KPF-së dhe jemi të kompletuar si Komitet.

**z.Faik Muçiqi,** Drejtor i DSHPMSH, theksoi, meqë dy drejtor të dy Drejtorive për momentin nuk janë prezent në këtë mbledhje, unë do përpiqem të paraqesë arsyet e këtij propozim vendimi. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit më ka përcjellë disa plotësime ndryshime sa i përket rialokimit të mjeteve buxhetore të Drejtorisë në fjalë, të cilat sigurisht se do ti paraqes në vazhdim, por nesër drejtori i cekur do të jetë prezent në mbledhje dhe të njëjtat do ti paraqesë dhe arsyetoj edhe vetë, ndërsa për rëndësinë e rialokimit sigurisht që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave nesër do të paraqet fjalën hyrëse, edhe pse besoj se të gjithë jeni në dijeni për rëndësinë e rialokimit i cili natyrisht që parashihet edhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe me dispozita tjera ligjore.

Këshilltarëve të Kuvendit të Komunës ju është përcjellë materiali përkatës, mirëpo në ndërkohë meqë dinamika e projekteve ka ndryshuar, janë bërë edhe disa plotësime ndryshime sa i përket rialokimit të buxhetit sipas propozim vendimit, andaj për të qenë sa më korrekt unë do t'i lexoj ato plotësime ndryshime dhe të njëjtat do t'i përcjellë zyrtarëve për punë të Kuvendit, natyrisht nëse pas diskutimeve të njëjtat miratohen, në mënyrë që të njëjtat t'ju përcillen nesër të gjithë këshilltarëve të Kuvendit.

Në nenin I të propozim vendimit, te pjesa e rialokimit të mjeteve, shtohen, si vijon;

- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dyz,( Lagjet Maloku dhe Berisha), kodi-44658, shuma, 40,000 €,
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Siboc (te Xhamia e vjetër), kodi-46150, shuma, 30,000 €,
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llugë (Lagja Zhitia), kodi-45949, shuma, 25,000 €, ndërsa shuma e mjeteve prej 703,700 € të propozuara për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugëve "Zahir Pajaziti" dhe "Skenderbeu" në qytet, kodi-44621, ndryshohet në 608.700 €, pra kjo ishte tek DPUMM ku kemi të bëjmë me disa projekte brenda kodeve ekzistuese të miratuara por që ndryshohet shuma e kodit – projektit të fundit.

Pastaj tek DSHPMSH kemi dy ndryshime më të vogla ku nuk ka ndryshim të projekteve e as kodeve por vetëm bëhet fjalë në ndryshimin e dy shumave, dhe atë:

Neni II i propozim vendimit, ndryshohet dhe plotësohet, si vijon;

- Pika 2, shuma prej 24,500 €, ndryshohet në 24,000 €,

Ndërsa te pjesa e rialokimit të mjeteve; - Pika 1, shuma prej 119,780 €, ndryshohet në 119,280 €.

Neni III i propozim vendimit, ndryshohet dhe plotësohet, si vijon;

- Pika 1, shuma e mjeteve prej 18,500 € të propozuara për zgjerimin dhe e rrjetit të ujësjellësit, kodi-85209, ndryshohet në 7,500 €.

Ndërsa te pjesa e rialokimit të mjeteve; - Pika 1, shuma prej 26,000 €, ndryshohet në 15,000 €, ndryshim plotësime këto për arsye se në këto projekte disa tenderë janë me shuma më të larta dhe disa më të ulëta, andaj ne duhet ti plotësojmë, respektivisht t'i reduktojmë ato shuma sipas ofertave fituese të tenderëve.

Brenda DSHPMSH gjithsej shuma e propozuar për rialokim është 207,580,00 € apo 9.52%, kurse tek DPUMM shuma e propozuar për rialokim është afër 25% e buxhetit të Drejtorisë.

**z.Avni Fetahu,** theksoi, pas sqarimeve që i bëre drejtori parafolës, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim duke përfshirë edhe plotësime ndryshimet e paraqitura nga parafolësi dhe

njëkohësisht i rekomandojmë kuvendit për shqyrtim dhe miratim, kur sigurisht se do të kemi sqarime dhe arsye më në detaje rreth rëndësisë së këtij propozim vendimi.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit të Komunës që kjo pikë të shqyrtohet, kurse vërejtjet tona do t'i paraqesim nesër në mbledhjen e Kuvendit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandon Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike ku natyrisht se do të diskutohet dhe mund të ketë ndonjë vërejtje eventuale në projekte të ndryshme, por që rialokimi është mirë të ndodh për shumë arsye.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, nuk kam ndonjë koment në lidhje me përmbajtjen e këtij propozim vendimi, por vetëm dëshiroj të ndërlidhmë në kuptim të mandatit të KPF-së ku ne vazhdimisht po i rekomandojmë që çështjet përkatëse të shqyrtohen Kuvendin e Komunës, por nuk di se sa është në rregull kjo mënyrë se si ne po veprojmë si Komitet, andaj desha të hap si çështje këtë sepse ne në fakt po i rekomandojmë Kuvendit por ndoshta paraprakisht do të duhej të shqyrtonim pikat në fjalë edhe pse e kuptoj se ndoshta në detaje nuk mund ta shqyrtojmë këtu po unë mendoj se ndoshta paksa po e devijojmë punën e KPF-së meqë edhe po të jetë mandati jonë rekomandues, çdo çështje para se ta rekomandojmë paraprakisht duhet ta shqyrtojmë, në terma të përgjithshëm ndoshta. E them këtë duke marrë shkas edhe nga mbledhjet e kaluara ku vazhdimisht kemi shkuar me avazin e rekomandimeve, andaj mendoj se ndoshta do të ishte mirë t'i japim më shumë kuptim KPF-së, të diskutojmë çështjet me rëndësi dhe pastaj t'i rekomandojmë Kuvendit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nëse parafolësja ka çështje për të diskutuar mund ta bënë një gjë të tillë sepse është anëtare sikurse që jemi edhe ne, edhe pse deri tani asnjëherë nuk ka diskutuar fare diçka me rëndësi për tema të caktuara. Ne në bazë të kompetencave që ka KPF jemi në dijeni se ky Komitet i rekomandon Kuvendit rendin e ditës apo pikat e rendit të ditës, ose mund të ndodh të ndaloj ndonjë pikë të diskutohet në Kuvend. Në bazë të ligjeve në fuqi KPF është rekomandues e jo vendimmarrës, kështu që ne në emër të Grupit të PDK-së mendojmë se rialokimi i mjeteve buxhetore është i arsyeshëm të bëhet dhe një gjë të tillë e bëjnë pothuajse të gjitha Komunitatet, kurse për specifikime në projekte të caktuara që riallokohen mund të kemi vërejtje, shembull, tek renovimi i objekteve shëndetësore unë kam vërejtje sepse në bazë të shumë shumave buxhetore që jemi në dijeni janë ndërtuar një numër i objekteve të reja të ambulantave dhe në këtë kontekst nuk e kam disponimin e plotë që 50,000.00 € nga kodi për pajisje mjekësore të riallokohen për renovim të objekteve shëndetësore për arsye se në shumicën e fshatrave janë ndërtuar qendra të reja, kurse për gjendjen e objekteve në qytet për momentin nuk jam në dijeni por ndoshta me ndonjë arsyetim kjo çështje mund të arsyetohet.

Unë jam opozitë por konsideroj se rialokimi i buxhetit është çështje që ka mbështetje ligjore, mirëpo nuk dëshiroj të ndalem në secilën pikë të projektit ngase po të na pyesin neve secili prej nesh do të kishte propozime për ndërrime – përfshirje të projekteve të ndryshme. Përndryshe ne nuk jemi të interesuar të ndalim këtë pikë por mendojmë se është mirë të shqyrtohet në Kuvend, kështu që me disa projekte pajtoj plotësisht siç janë dy projektet për fshatin Dyz, por kjo nuk do të thotë se jam kundër projekteve tjera, edhe pse ndoshta do të doja që disa prej tyre të zëvendësohen me projekte tjera më të rëndësishme. Pastaj jemi dëshmitarë se edhe në mandatin e kaluar është diskutuar shumë çështja e ndërtimit të fushave të hapura sportive, mandej renovimi i objektit të Teatrit etj, e që ne i kemi dhënë mbështetje, pra dua të them se nuk jemi kundër investimeve në fusha të ndryshme, mirëpo në parim jam që të diskutohet pika sipas të cilës mjetet prej 50,000.00 € për pajisje mjekësore është kërkuar të riallokohen për renovime të objekteve shëndetësore, pastaj kemi rrugën në Lagjen Zhitia e paraparë në fshatin Llugë e cila për katër vite ka qenë e planifikuar të asfaltohet, andaj kur njëherë marrim vendim për një projekt të caktuar, kurdo që ai projekt vjen koha të realizohet nuk duhet që ta kundërshtojmë. Pra ne mund të diskutojmë parimisht dhe mund të japim qëndrime në emër të Grupeve të këshilltarëve, por anëtarëve të KPF-së askush nuk jua ndalon të marrin fjalën dhe të diskutojnë për çështje të caktuara.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, sqarim parafolësit, nuk e thash që nuk duhet të rekomandojmë sepse ne shefat e Grupeve të këshilltarëve vetë i kemi zgjedhë dhe kur ata japin një qëndrim normal që është qëndrim politik i subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës por edhe në këtë Komitet. Çështja ishte rreth funksionimit të KPF-së sepse në mandatin e kaluar nuk kam qenë pjesë e këtij Komiteti dhe nuk di si ka funksionuar, por po diskutoj për mandatin aktual ku në fillim kemi filluar me shqyrtimin e disa çështjeve dhe pika përkatëse, andaj këtë e shtrova nga frika e degradimit të punës së KPF-së ngase nëse vetëm vijmë në mbledhje dhe themi se vetëm i rekomandojmë atëherë nuk di sa ka kuptim. Nuk e kam personalisht me askënd këtë që e them por jam në dijeni se çështjet duhet paraprakisht të shqyrtohen e pastaj të rekomandohen me apo pa plotësim ndryshime, vërejtje etj të ngjashme. Sa i përket çështjes së diskutimeve, procesverbalet ekzistojnë dhe mund ta shohë gjithsecili se a ka diskutuar ndonjëherë dhe kush dhe çka ka debatuar.

**z.Rafet Llapashtica**, i drejtohet parafolëses, e nderuar kolege, kompetencat e KPF janë të rregulluara me ligjet dhe aktet tjera në fuqi, Rregulloret e brendshme, Statutin e Komunës, e që së pari çdo anëtar i KPF-së duhet ti dinë në përpikëri. Po ti shohim obligimet dhe detyrat tona me të cilat ngarkohemi, janë të shumta, por pyes parafolësen a jeni 100% e gatshme si anëtare nga radhët e LDK-së të zbatoni të gjitha obligimet dhe detyrat e këtij Komiteti, e që fillimisht detyrë e KPF-së ndër të tjera është edhe plani i prokurimit. Pastaj parafolësja e tha se po degradohem, unë po e di që jemi të degraduar sepse po të propozoj unë diçka e di që ju personalisht nuk e votoni, sepse edhe vetë jam shumë i interesuar të kryej punën time si anëtarë i këtij Komiteti në mënyrën më të mirë sepse KPF është trup më i lartë i Kuvendit, andaj vetëm a jeni ju që e sillni planin e prokurimit, dhe planin e realizimit të projekteve këtu në KPF, unë i mbështes.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, parafolësi e mori personalisht këtë, mirëpo ajo që unë e ceka ishte vetëm si çështje e shtruar, pastaj është krejt tjetër çështje të propozohet, tjetër çështje të votohet ngase propozimi është plotësisht i drejtë mirëpo pastaj a kalon apo jo është çështje tjetër. Pikërisht çështjen e shtruar e ceka sepse kemi të bëjmë me trupën - organin më të lartë të Kuvendit.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, nuk pajtoj me asnjërin nga dy parafolësit paraprak sa i përket asaj që e ceken se KPF është e degraduar, gjë e cila nuk qëndron dhe nga ajo shprehje diferencohem, nëse thuhet që ky Komitet është i degraduar, unë dua ta dijë përse. Pra kur flitet diçka duhet të argumentohet, e jo vetëm të thuhet, ngase pastaj po del një akuzë e rëndë. Përndryshe nuk ka asgjë të keqe që diskutohet dhe që ka mospajtime mes anëtarëve në pika të caktuara, ndërsa sa i përket kompetencave dhe përgjegjësi të KPF-së besoj se të gjithë deri në një masë jemi në dijeni dhe i kemi lexuar disa herë dhe vazhdimisht i kemi zbatuar aq sa kemi mundur, kështu që askush askënd nuk mund t'i thotë se, ju nuk i dini kurse unë i di, e gjëra të ngjashme.

**znj.Fatlume Jaha**, sqarim, ndoshta u keqkuptua ajo që unë e ceke, në fakt unë e thash që mos të degradohem ne si KPF.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, KPF-në nuk e drejton opozita por e drejton Kryesuesi i Kuvendit i cili është edhe Kryesues i këtij Komiteti, dhe nëse kemi degradim apo jofunksionim të mirë, barra bie mbi Kryesuesin.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, nëse vërtetë ndokush tenton të degradoj KPF-në, atëherë konkretisht ata që e than se mos ta degradojmë, ta marrin fjalën dhe t'ia japim hijeshinë mbledhjeve të këtij Komiteti, të kyçen me diskutime dhe të japin propozime dhe kontributet e tyre, mirëpo në këtë aspekt jam shumë i bindur se shumë pak qëndron bashkëpunimi i asamblistëve të LDK-së me drejtorët e Drejtorive Komunale, madje informatat dhe materialet tjera ju sjellën të gatshme ashtu sikurse neve, e jo që merreni shumë me hallet dhe nevojat e qytetarëve.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, kjo që parafolësi e tha është vetëm një paragjykim parashikim i tij personal. Për të qenë e qartë atë se çfarë unë desha të them në fillim, është se po paraqiten vetëm qëndrimet politike.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, konsideroj diskutimet për këtë pikë përfunduan, madje dolëm edhe jashtë kësaj pike. E hedh në votim duke përfshirë edhe plotësim ndryshimet e propozuara nga drejtori i DSHPMSh.

*U konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke përfshirë edhe plotësim ndryshimet e paraqitura në fjalën hyrëse nga z.Faik Muçiqi drejtor i DSHPMSh, dhe atë:*

- Në nenin I të propozim vendimit, te pjesa e riallokimit të mjeteve, shtohen:
  - Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dyz,( Lagjet Maloku dhe Berisha), kodi-44658,shuma.....40,000 €
  - Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Siboc (te Xhamia e vjetër), kodi-46150, shuma .....30,000 €
  - Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llugë (Lagja Zhitia), kodi-45949, shuma.....25,000 €*Ndërsa shuma e mjeteve prej 703,700 € të propozuara për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugëve ‘‘Zahir Pajaziti’’ dhe ‘‘Skenderbeu’’ në qytet, kodi-44621, ndryshohet në 608.700 €.*
- Neni II i propozim vendimit, ndryshohet dhe plotësohet, si vijon:
  - Pika 2, shuma prej 24,500 €, ndryshohet në 24,000 €.*Te pjesa e riallokimit të mjeteve:*
  - Pika 1, shuma prej 119,780 €, ndryshohet në 119,280 €.
- Neni III i propozim vendimit, ndryshohet dhe plotësohet, si vijon:
  - Pika 1, shuma e mjeteve prej 18,500 € të propozuara për zgjerimin dhe e rrjetit të ujësjellësit, kodi-85209, ndryshohet në 7,500 €.*Te pjesa e riallokimit të mjeteve:*
  - Pika 1, shuma prej 26,000 €, ndryshohet në 15,000 €.

### **3. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2018/2019**

**z.Agim Blakçori,** U.D. Drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, meqë dje ka filluar viti i ri shkollor 2018/2019 shfrytëzoj rastin t’jua uroj një vite të mbarë dhe të suksesshëm të gjithë nxënësve dhe punëtorëve të arsimit. Procesi mësimor ka filluar me kohë dhe pa kurrfarë problemesh në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës. Renovimet që janë zhvilluar gjatë pushimit verorë pothuajse veç janë në fazën finale të realizimeve dhe nuk kanë paraqitur ndonjë problem sa i përket fillimit të procesit mësimor. Po ashtu sa i përket kuadrit shkollorë të gjitha përgatitjet janë bërë me kohë si dhe të gjitha përgatitjet tjera rreth procesit mësimor janë bërë me kohë, kështu që gjërat tjera më në detaje janë në informatë dhe mund t’i diskutojmë në vazhdim.

**z.Avni Fetahu,** theksoi, informatën e kemi lexuar dhe kemi vërejtur se paraqiten të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fillimin e vitit të ri shkollorë, është një informatë shumë përmbajtësore, andaj duke uruar për një vit të mbarë dhe të suksesshëm e mbështesim që e njëjta të diskutohet edhe në Kuvendin e Komunës ku sigurisht se do të diskutohet më gjatë.

**z.Fitim Haziri,** theksoi, para se t’i rekomandojmë Kuvendit, në formë të pyetjes dua të ngris çështjen rreth buxhetit për arsim ku para një kohe na është thënë se Ministria e Financave ka ndarë buxhet për arsimin më pak se viteve tjera dhe si rrjedhojë na duhet të shkurtojmë vendet e punës në arsim për 60 mësimdhënës.

**z.Agim Blakçori,** Drejtor i DKA, theksoi, çështja e cekur nga parafolësi ka të bëjë me vitin 2019 kështu që për këtë fillim vit nuk paraqet ndonjë problem, mirëpo edhe përkundër kësaj ne kemi ndërmarrë të gjitha veprimet, kemi adresuar problemin në instanca më të larta dhe kemi kërkuar që çështja në fjalë mos të ndodh, të paktën përnjëherë në vitin 2019, por të bëhet për tri vitet e ardhshme, për çdo vit nga 20, andaj

shpresojmë që Ministria e Financave të merr parasysh kërkesat e Komunave në mënyrë që të programojmë stafin, buxhetin dhe të mos shpallim konkurse aty ku ka kuadra me gjysmë norme, t'i plotësojmë me norma të plota dhe ta shfrytëzojmë maksimum dhe racional afatin e dhënë nga Ministria e Financave ashtu siç kemi kërkuar. Vlen të ceket se buxheti për Komunitat ndahet në bazë të numrit të nxënësve e që Komuna e Podujevës ka rënie të numrit të nxënësve dhe si rrjedhojë edhe zvogëlim të buxhetit për arsim e që ndikon drejtpërsëdrejti në shkurtimin e numrit të punëtorëve të arsimit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, më shumë jam i interesuar të informohem se a ka arritur Drejtoria e Arsimit të bëjë regjistrimin e të gjithë nxënësve në shkollat e Komunës së Podujevës. Pastaj ne nuk jemi të njoftuar për numrin e nxënësve të cilët e kanë përfunduar maturën, sa janë regjistruar dhe sa nxënës kanë mbetur jashtë objekteve shkollore. Mandej kemi të bëjmë me pranimin e punëtorëve në arsim, shembull, kemi rastin për të cilin jam i informuar se një punëtor teknik është pranuar dhe ka filluar punën pa u bërë intervistimi i kandidatëve. Dua të them se janë disa defekte më të mëdha se sa të thuhet se shkollat janë të gatshme të fillojnë procesin mësimor. Në Komunën e Podujevës arsimi në mandatin e kaluar ka qenë skajshmërisht i degraduar, mirëpo tani po shoh se drejtori i ri i DKA-së e ka një ambicie më pozitive dhe më të arsyeshme se sa ish drejtori z.Avni Maloku i cili deri në atë gjendje e ka dërguar arsimin që edhe drejtori aktual e ka problem ta vë në rregull, por nuk po dëshiroj të hy në tema të tilla sepse jemi në dijeni se deri në cilin nivel ka rrëshqit arsimi sa ka qenë ish drejtori, çështje të cilat i kemi ngritë disa herë. Kështu që kërkoj nga drejtori aktual që ta drejton arsimin sa më mirë që të jetë e mundur, pastaj edhe nëse e piketon ndokënd për ta pranuar në punë, duhet të pritni procedurat e konkursit, e jo të ndodh sikurse në një rast tani të freskët për të cilin unë i kam të dhënat me emër dhe të gjitha tjera por që sot nuk do t'i cekë. Jam në dijeni se problemet në arsim i ka lënë dikush tjetër dhe tani drejtori aktual mundohet t'i përmirësoj por kam bindjen se do ta ketë shumë të vështirë. Pavarësisht se jemi në opozitë, në disa çështje nuk kemi bindjet apo vërejtjet tona veç pse jemi opozitë, por nga dëshira që fusha e arsimit të jetë njëra prej më të suksesshme, andaj edhe na duhet të ngritim çështje të caktuara. Mos të merret kjo që e ceka si kundërshtim i informatës apo diçka personale me ndokënd, por do të ishte mirë që nesër në Kuvend të përgatiteni dhe të na informoni për numrin e nxënësve të regjistruar, të paregjistruar, sa kanë mbetur jashtë objekteve shkollore, pastaj të na informoni për drejtorët e shkollave të emëruar apo siç janë që një kohë me ushtrues detyre, si janë zgjedhur etj, si dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me arsimin, sepse me këtë ia leton punën vetit si drejtor i Drejtorisë. Këtë e them në mënyrën më kolegiale të mundshme, përndryshe shumica e informatave që duhet të jenë rreth fillimit të vitit të ri shkollore janë në këtë dokument.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, në bazë të diskutimeve të zhvilluara, kërkoj që kjo informatë të plotësohet edhe me statistikat e kërkuara rreth numrit të nxënësve të regjistruar, atyre që kanë mbete pa u regjistruar duke përfshirë edhe sqarimin rreth rastit të cekur për punësim në arsim.

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA, sqarime, në kohën kur është përgatitur kjo informatë, para rreth 10 ditëve, dhe deri më sot veç është shpallë konkursi për plotësimin e nxënësve në shkollat e mesme ku është edhe një numër i cili nuk është regjistruar, kësaj i referohem në bazë të numrit të atyre që kanë përfunduar arsimin nëntëvjeçar, mirëpo ka edhe të atillë të cilët kanë aplikuar në shkollat tjera të Komunave tjera ku tani vetëm i kemi vërejtur disa prej tyre të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen dhe sërish kanë aplikuar në shkollat e Komunës së Podujevës, problem ky me të cilin jemi duke u marrë dhe besoj se do të gjejmë zgjidhje.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, i ceka disa raste por për disa edhe nuk u ndala fare, shembull në shkollën e fshatit Batllavë, në listat e pagave figuron edhe emri i sekretarit të shkollës i cili nuk shkon në shkollat asnjëherë. Edhe njëherë po e përsëris që nuk i them disa gjëra rreth arsimit vetëm pse jam opozitë por ato i them në mënyrën më njerëzore dhe qëllimshme sa i përket çështjeve në interes të përgjithshëm. Gatishmëria jonë është për të përmirësuar arsimin, mirëpo kur një Drejtori posedon të gjitha kushtet,

kualifikimit dhe çështjet tjera të një aplikuesi për të udhëhequr me një shkollë dhe ai nuk zgjedhet drejtor i asaj shkolle për arsye politike, nuk mund të themi se është në rregull. Pra e ceka rastin e sekretarit të shkollës së fshatit Batllavë i cili figuron në listat e pagave dhe merr pagë, e që mendoj se ai person duhet të qëndroj në vendin e punës, pastaj psikologët të cilët paguhen për të kryer punën e tyre në shkollat përkatëse duhet të qëndrojnë në ato shkolla dhe ta kryejnë punën e tyre, dhe diskutimi im ishte në këtë kontekst. Sërish po i kthehem asaj që paraprakisht e ceka se deri ku ka shkuar arsimi për katër vite në mandatin e kaluar nën udhëheqjen e një drejtori me të cilin kam qenë më i pakënaquri sepse ish drejtori z.Avni Maloku e ka degraduar arsimin deri në atë masë që unë mendoj se ju si drejtor i Drejtorisë së bashku me Kryetarin e Komunës e keni shumë të vështirë ta sjellni në zero, mirëpo ato parregullsi dhe lëshime duhet të eliminohen disi.

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA, theksoi, sa i përket çështjes së cekur rreth konkursit për punëtor teknik fillimisht është shpall dhe zhvilluar një konkurs publik dhe është pranuar një punëtor, ndërkohë është shpallur edhe një konkurs tjetër për dy punëtor teknik, njëri në shkollën “Shaban Shala” në qytet dhe njëri në shkollën “Musli Dumoshi” në fshatin Dumosh dhe ende nuk është bërë pranimi i tyre, andaj nuk qëndron ajo që u tha se dikush ka filluar punën pa përfunduar procedurat e konkursit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, drejtori parafolës e ceku që keni hapur konkursin për punëtor teknik në shkollën “Shaban Shala” në Podujevë, mirëpo këtu janë të gjithë prezent dhe mund ta vërtetojmë pastaj, nëse vie punëtor teknik në këtë shkollë Halit Nazif Blakçori, ju e bëni ashtu siç e ceka unë, ndërsa në rast se vie një punëtor tjetër, prapa saj është dikush tjetër. Prandaj nuk po them diçka që është e padrejtë, ai person është duke punuar, mirëpo tani mund të thoni çfarë të doni ju, konkursi tek është i hapur dhe presim. Nuk jam kundër punësimeve por jam që të respektohen procedurat.

**z.Agim Blakçori**, përgjigje parafolësit, sa i përket pranimi të punëtorëve është çështje e komisionit përkatës, jo e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, por nuk mund të themi se ndokush fillon punën pa përfunduar procedurat e konkursit.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, sa i përket informatës së Drejtorisë së Arsimit, natyrisht se i shërben transparencës, përtej përmbajtjes që ka sepse përmbajtja paraqet gjendjen reale e cila qëndron në arsimin e Komunës së Podujevës. Pa modesti dëshiroj ta falënderoj drejtorin për sjelljen e një informate të tillë por edhe për faktin që e njëjta është sjellë me kohë sipas Planit të punës së Kuvendit. Unë nga këtu përçoj mesazhin që të vazhdohet me këtë ritëm të punës, çështje për të cilën prita që anëtarët nga opozita ta potencojnë një gjë të tillë sepse vazhdimisht kanë bërë kritika se informatat nuk po sjellën me kohë, dhe gjëra të ngjashme.

**z.Rafet Llapashtica**, i drejtohet parafolëses, shumë mirë që kjo informatë është sjellë me kohë, por unë pyes parafolësen, si këshilltare e Kuvendit në mandatin e dytë a jeni në dijeni po t’ju pyes ndokush sa nxënës kanë mbetur jashtë procesit mësimorë dhe a jeni në dijeni sa nxënës kanë shkollat e Komunës së Podujevës, çfarë ju përgjigjesh atyre. Pastaj mendoj se më shumë i vlejnjë drejtorit të DKA-së kritikën që unë i bëj sesa lëvdata e parafolëses. Unë shprehi gatishmëri që t’i ndihmoj drejtorin për cilëndo shkollë vetëm e vetëm që shkolla të vie në rregull, gjë të cilën besoj se është i gatshëm ta bëjë secili sepse nuk jemi këtu vetëm që t’i ndjekim vijat tona politike, por jemi për interesa të qytetarëve, mirëpo nëse mendojmë vetëm në baza partiake nuk është në rregull.

Edhe njëherë, unë si këshilltar dëshiroj të dijë, sa nxënës kanë përfunduar shkollimin fillor, sa nxënës janë regjistruar, sa kanë mbetur jashtë procesit mësimor dhe sa vijnë shkollimin. Tani personalisht po e them, kur një shkollë ku ish drejtori z.Avni Maloku e ka mbajtur 8 vite me ushtrues detyre apo që Kryetari e mban në punë një person në pension kurse në anën tjetër ka përplot persona adekuat të kualifikuar për punë, me mua gjëra të tilla nuk keni çfarë të diskutoni.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, po e çmoj në një formë qëndrimin e parafolësit i cili e ngriti këtë si çështje, duke u bazuar në atë që unë qysh në fillim të mbledhjes e thash se është mirë të shqyrtohen dhe të diskutohen temat këtu paraprakisht.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, konsideroj se diskutimet rreth kësaj pike përfunduan, mendoj se i gjithë ky diskutim dhe këto gjëra që u ngritën janë në favor të ngritjes së arsimit sepse jemi në dijeni për rëndësinë e tij për një vend. Kam një përvojë në arsim rreth 20 vite dhe jam në dijeni se si funksionon arsimi në Republikën e Kosovës ku paraqiten problem të natyrave të ndryshme, por me një përkushtim të të gjithëve besoj se do të rregullohen të gjitha.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim*

#### **4. Propozimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.01-006-88066**

**z.Abaz Llugaliu**, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës kemi propozim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e një vendimi të Kuvendit të Komunës të marrë në vitin 2016 i cili ka të bëjë me caktimin e lokacionit për realizimin e fazës së projektimit për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në fshatin Orllan. Do të thotë bëhet fjalë vetëm për ndryshimin nga një parcelë në tjetrën, që të dyja pronë e Komunës me të vetmin qëllim për ta mbrojtur një burim të ujit.

*Pas votimi njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:15**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Enis Sheholli**

**Nr.01-016/01-0073349/18**  
**Podujevë,**  
**04 shtator 2018**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Fatmir Gashi**